



Pesë Vite Akreditim për Akademinë e Forcave të Armatosura, Një Dëshmi e Ekselencës në Arsimin Ushtarak Shqiptar



faqe 3



MINISTRI I MBROJTJES PIRRO VENGU NË "PARIS AIR SHOW": HAPJE E RE NË BASHKËPUNIMIN USHTARAK SHQIPËRI-FRANCË

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë zyrtare në Francë, ku u prit nga homologu i tij francez, z. Sébastien Lecornu, me rastin e hapjes së "Paris Air Show" (Salon du Bourget), një prej eventeve më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e aviacionit... » faqe 3



KODI I IDENTITETIT USHTARAK MË SHUMË SE VESHJE: UNIFORMA USHTARAKE, NDERI I SHËRBIMIT SHQIPTAR

Me Uniformë për Kombin: Disiplina dhe Dinjiteti në Shërbim
Uniforma ushtarake e Forcave të Armatosura të Shqipërisë ka një rol dhe rëndësi të shumëfishtë në funksionimin, identitetin dhe disiplinën e ushtrisë. Identiteti dhe përfaqësimi. Uniforma është simbol i përkatësisë ndaj... » faqe 8



TEKNOLOGJIA SI ARMATIM: LUFTA E RE E SHEKULLIT XXI NË ARENËN USHTARAKE

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

"Lufta e së ardhmes do të fitohet nga ata që zotërojnë informacionin, jo vetëm armët". Në një epokë ku çdo klikim, postim dhe bashkëbisedim virtual mund të shndërrohet në armë, forcat tona ushtarake përballen me sfida që shtrihen përtej frontit të armatosur. Nuk është më e mjaftueshme të zotërosh... » faqe 7

Forcat e Armatosura Shqiptare në Takimin e Zëvendësshefave të Shtabit të Përgjithshëm të SEDM-it, në Sofje

Në kuadër të iniciativës së Ministerialit të Mbrojtjes të Evropës Juglindore (SEDM), u zhvillua në Sofje takimi vjetor i zëvendësshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve pjesëmarrëse, ku Bullgaria ishte vendi pritës. Shqipëria u përfaqësua nga gjeneral brigade Altin Kurti, zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ky takim ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ushtarak rajonal, rritjen e stabilitetit, ndërtimin e besimit dhe përmirësimin e sigurisë në Evropën Juglindore dhe më gjerë. Në fjalën e tij, gjeneral brigade Kurti falënderoi Bullgarinë për mikpritjen dhe vlerësoi ecurinë e iniciativës gjatë kryesimit të saj nga Rumania.

Gjenerali Kurti theksoi angazhimin e Shqipërisë për të çuar përpara bashkëpunimin rajonal në fushat e edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta. Ai nënvizoi rëndësinë e tre prioritetëve kyçe për të ardhmen e SEDM-it: forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ndërmjet vendeve anëtare, rritja e kapaciteteve dhe ndërveprimit të Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG) si instrument ushtarak i SEDM-it, dhe zhvillimi i bashkëpunimit civilo-ushtarak për përballimin e krizave të sigurisë.

Në përmbyllje të fjalës së tij, gjeneral brigade



Kurti deklaroi: “Shqipëria e konsideron SEDM-in një platformë të rëndësishme për dialog dhe bashkëpunim konkret, me rezultate të dukshme në terren. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë të vendosura të punojnë krah për krah me partnerët rajonalë për një Evropë Juglindore më të sigurt, më të qëndrueshme dhe më të begatë”.

Takimi u mbyll me miratimin e “Deklaratës së Përbashkët” nga të gjithë pjesëmarrësit, e cila pasqyron angazhimin e tyre të vazhdueshëm për paqen dhe sigurinë në rajon.

Konferenca e ardhshme e DCHODs pritet të mbahet në qershor 2026 në Tbilisi, Gjeorgji.

Stërvitja “Reagimi ndaj Zjarreve Masive 2025” Teston Gatishmërinë e Strukturave të Emergjencës

Për dy ditë me radhë, zona e Gërhotit në Gjirokastrë u bë arenë e stërvitjes funksionale (CPX) “Reagimi ndaj zjarreve masive 2025”, e organizuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), në bashkëpunim me Bashkinë dhe Prefekturat e Qarqeve Gjirokastrë dhe Vlorë, si dhe me pjesëmarrjen aktive të të gjitha strukturave të mbrojtjes civile të të dy qarqeve.

Në aktivitet morën pjesë figura kyçe të pushtetit vendor dhe qendror, përfshirë Drejtorin e AKMC-së Haki Çako, Prefektin e Qarkut Gjirokastrë Odise Kote, Prefektin e Qarkut Vlorë Plator Nesturi, Kryetarin e Bashkisë Gjirokastrë Flamur Golemi, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera vendore, qendrore dhe ndërkombëtare.

Në deklaratën e tij, z. Çako theksoi se kjo stërvitje është pjesë e një strategjie të gjerë për përballimin e zjarreve gjatë sezonit veror. “Fokusi kryesor është mbrojtja e jetës së qytetarëve, pronës, vlerave kulturore, gjësë



së gjallë dhe të gjitha resurseve që ka vendi jonë”, - u shpreh ai.

Z. Çako nënvizoi ndikimin e ndryshimeve



klimatike dhe faktorit njerëzor në rritjen e rrezikut nga zjarret, duke shtuar se “90% e zjarreve janë si pasojë e faktorit njeri”. Ai bëri

thirrje për ndëshkrimin ligjor të zjarrvënësve dhe falënderoi të gjitha strukturat për angazhimin e tyre.

Stërvitja përfshiu ushtrime të ndryshme si evakuim, ndihmë e parë, operacione kërkim-shpëtimi dhe koordinim ndërinstitutional. Aktiviteti u mbështet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) përmes projektit RESEAL, i financuar nga qeveritë e Suedisë, Portugalisë, Zvicrës dhe Shqipërisë.

Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile shprehën mirënjohjen për qytetarët për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e treguar gjatë zhvillimit të stërvitjes, që synon forcimin e kapaciteteve për përballimin e emergjencave në të ardhmen.



Pesë Vite Akreditim për Akademinë e Forcave të Armatosura, Një Dëshmi e Ekselencës në Arsimin Ushtarak Shqiptar

Akademia e Forcave të Armatosura është akredituar institucionalisht për një periudhë pesëvjeçare, sipas vendimit të fundit të Bordit të Akreditimit. Ky vlerësim i rëndësishëm për arsimin e lartë shqiptar konfirmon përmbushjen e standardeve akademike dhe administrative nga kjo akademi ushtarake.

Ky zhvillim përbën një dëshmi të qartë të përkushtimit të AFA-së për të garantuar cilësi në arsimin ushtarak dhe në kërkimin shkencor, duke synuar përgatitjen sa më të mirë të studentëve dhe oficerëve të ardhshëm të Forcave të Armatosura.

Akreditimi pesëvjeçar jo vetëm që rrit besueshmërinë institucionale, por njëkohësisht thekson angazhimin për zhvillim profesional në përputhje me sfidat bashkëkohore të sigurisë dhe mbrojtjes. Kjo është një arritje domethënëse për AFA-në dhe një hap përpara në konsolidimin e saj si institucion i arsimit të lartë ushtarak në vend.



AKREDITIMI PESËVJEÇAR JO VETËM QË RRIT BESUESHMËRINË INSTITUCIONALE, POR NJËKOHËSISHT THEKSON ANGAZHIMIN PËR ZHVILLIM PROFESIONAL NË PËRPUTHJE ME SFIDAT BASHKËKOHORE TË SIGURISË DHE MBROJTJES.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu në “PARIS AIR SHOW”: Hapje e re në bashkëpunimin ushtarak Shqipëri-Francë

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë zyrtare në Francë, ku u prit nga homologu i tij francez, z. Sébastien Lecornu, me rastin e hapjes së “Paris Air Show” (Salon du Bourget), një prej eventeve më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, ushtarak dhe teknologjive të mbrojtjes.

Ky aktivitet prestigjioz, i cili mbledhi liderë politikë, prodhues të industrisë së mbrojtjes dhe përfaqësues të forcave të armatosura nga e gjithë bota, ofroi një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e përvojës dhe nxitjen e bashkëpunimeve të reja teknologjike.

Gjatë qëndrimit në Francë, ministri Vengu zhvilloi një sërë takimesh dypalëshe me homologë të vendeve të tjera si dhe drejtues të kompanive të njohura të industrisë së mbrojtjes, ku fokusi kryesor ishte thellimi i bashkëpunimit ushtarak mes Shqipërisë dhe Francës.

“Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë ekspozitë tregon angazhimin tonë për të ndjekur hapat e modernizimit dhe për të ndërtuar partneritete afatgjata në fushën e mbrojtjes dhe teknologjisë”, - deklaroi ministri Vengu, duke vlerësuar njëkohësisht mikpritjen e ministrit Lecornu.



Në vijim të marrëveshjeve të dakorduara gjatë vizitës së Presidentit francez Emmanuel Macron në Tiranë, muajin e kaluar, u nënshkrua kontrata me kompaninë prestigjioze “Thales Group” për pajisjen e Forcës Ajrore Shqiptare me një radar modern për vëzhgimin e hapësirës ajrore kombëtare.

Ky investim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së kapaciteteve mbrojtëse të Shqipërisë dhe përforcimit të rolit të saj brenda NATO-s, duke përfutur nga eksperiencia dhe mbështetja e partnerëve strategjikë si Franca.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një inspektim në laboratorin ushtarak të Spitalit të Traumës, një ndër investimet më të rëndësishme në fushën e shëndetësisë për efektivet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ky laborator modern, i përfunduar në mesin e vitit 2024, ofron shërbime për mbi 75 mijë përfitues të Statusit të Ushtarakut, bazuar në ligjin nr. 9210 “Për statusin e ushtarakut”. Përfitues janë jo vetëm ushtarakët në shërbim aktiv dhe familjarët e tyre, por edhe ushtarakët në rezervë, kadetët, studentët ushtarakë, rekrutët, trupat e atasheve ushtarakë të huaj dhe efektivet pjesëmarrës në stërvitje dhe trajnime në vendin tonë.

Gjatë vizitës, ministri Vengu u njoh nga afër me të gjitha investimet e realizuara dhe vlerësoi laboratorin si një shtyllë të domosdoshme për shëndetin dhe gatishmërinë e Forcave të Armatosura. Ai theksoi se ky shërbim garanton mbështetje mjekësore profesionale dhe moderne për çdo ushtarak, në çdo kohë.

Laboratori ushtarak kryen 45 analiza të ndryshme nga spektri klinik, biokimik dhe bakterologjik, duke përdorur pajisje të teknologjisë së fundit, të njëjta me ato të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Stafi përbëhet nga 13 specialistë, si civilë ashtu edhe ushtarakë, të cilët sigurojnë një standard të lartë profesionalizmi dhe cilësie në shërbim.

Ky investim shënon një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të infrastrukturës shëndetësore ushtarake dhe konfirmon përkushtimin e institucioneve për t’u kujdesur për trupat e armatosura dhe familjarët e tyre.



Ministri i Mbrojtjes inspekton laboratorin ushtarak në Spitalin e Traumës: Investim strategjik për shëndetin e Forcave të Armatosura



Trupat e Regjimentit të Këmbësores së Jugut nisen për mision në Kosovë

Në ambientet e Garnizonit të Këmbësores së Jugut u zhvillua një ceremoni solemne me rastin e nisjes së kontingjentit të këtij regjimenti, i cili do të shërbejë në përbërje të kompanisë italiane në kuadër të Batalionit Kinetik të Komandës Rajonale Perëndimore (RC-W) në Pejë, Kosovë.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Regjimentit të Këmbësores së Jugut, kolonel Gëzim Marku, zëvendëskomandanti nënkolonel Agron Muka, familjarë të efektiveve dhe përfaqësues të tjerë të strukturave ushtarake.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kolonel Marku vlerësoi profesionalizmin, përkushtimin dhe seriozitetin e trupave që nisen drejt misionit ndërkombëtar. “Jam i bindur në suksesin e misionit tuaj, bindje të cilën e mbështes në njohjen e aftësive tuaja profesionale, përkushtimin dhe seriozitetin e treguar gjatë gjithë ciklit stërvitor para dislokues, veçanërisht në rajonin



stërvitor të Bizës gjatë stërvitjes ‘Immediate Response/Defender Europe-25’”, - theksoi ai.

Kolonel Marku garanto mbështetje të plotë për personelin në mision, duke theksuar se komanda e regjimentit do të jetë gjithmonë pranë tyre për çdo shqetësim apo nevojë, me qëllim lehtësimin e detyrës së tyre.

Fjalën e tij e mbajti edhe komandanti i kontingjentit, toger Maringlen Tomani, i cili falënderoi eprorët për besimin e dhënë dhe siguroi të pranishmit se misioni do të përmbushet me përkushtim të lartë dhe profesionalizëm.

Ky dislokim përbën një tjetër dëshmi të angazhimit të Forcës Tokësore në operacionet ndërkombëtare të sigurisë dhe paqes, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e NATO-s, duke rritur kontributin e saj në promovimin e paqes dhe stabilitetit rajonal.

Gjenerallejtënant Kingji pret zyrtarë të lartë amerikanë pas stërvitjes “Defender Europe-25”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim të rëndësishëm me zëvendëskomandantin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade LaPoint dhe zëvendësrektorin e Planifikimit të Komandës së Forcave Amerikane për Evropën (USEUCOM), gjeneral brigade McKinney.

Takimi u zhvillua menjëherë pas përfundimit të stërvitjes shumëkombëshe “Defender Europe-25”, ku të dy gjeneralët amerikanë ishin të pranishëm në “Ditën e Vizitorëve të Shquar”, një ngjarje kyçe e cila thekson rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar. Në këtë stërvitje morën pjesë gjithashtu përfaqësues të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit dhe të Forcës Detare të SHBA-së.

Gjatë bisedimeve u diskutua për vijimin e bashkëpunimit dypalësh me fokus në zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta, forcimin e kapaciteteve mbrojtëse si dhe realizimin e projekteve modernizuese në shërbim të forcimit të aftësive operacionale të FARSH-së. Gjenerallejtënant Kingji vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të USEUCOM për zhvillimin dhe konsolidimin e kapaciteteve të

Forcave të Armatosura të Shqipërisë, si dhe ndihmën konkrete të Gardës së Nju Xhersit në fushën e trajnimit, mirëmbajtjes dhe logjistikës.

Në takim, Kingji shprehu falënderime të veçanta për Komandën e Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën për zgjedhjen e Shqipërisë për të tretën herë radhazi si vend mikpritës i stërvitjes “Defender Europe”,



duke e cilësuar këtë si dëshmi të fortë të partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA-së. Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë që ky bashkëpunim ka për mbështetjen e planeve të mbrojtjes të NATO-s dhe për stabilitetin e rajonit të Ballkanit. Dy gjeneralët amerikanë

zhvilluan gjithashtu vizita në Komandën e Forcës Tokësore dhe Komandën e Forcës Ajrore, ku u pritën nga komandantët respektivë dhe u informuan mbi zhvillimet më të fundit në këto struktura dhe projektet e përbashkëta me partnerët amerikanë.

Në përfundim të takimit, të dyja palët ritheksuan vullnetin për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak, duke theksuar se angazhimi i SHBA-ve është thelbësor për forcimin e sigurisë rajonale dhe asaj euroatlantike.



Kursantët e KMS zhvillojnë seminar mbi Incidentin e Kanalit të Korfuzit

Në kuadër të modulit “E drejta në Forcat e Armatosura”, kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm zhvilluan një seminar tematik me fokus “Incidentin e Kanalit të Korfuzit”. Ky aktivitet u konceptua si një rast studimor për analizimin dhe zbatimin e së drejtës ndërkombëtare publike në kontekstin ushtarak. Seminari u inspektua nga Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes së Sigurisë (KMS), gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili vlerësoi nivelin e angazhimit dhe analizën profesionale të kursantëve mbi këtë çështje historike me rëndësi ndërkombëtare. Ky seminar përbën një shembull konkret të përfshirjes së praktikave akademike në përgatitjen profesionale të oficerëve të ardhshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Efektivë të Detashmentit të Mbështetjes Rajonale, Mengel, realizojnë operacionin për shuarjen e zjarrit në Malin e Krastës

Efektivë dhe mjete zjarrfikëse të kompanisë operacionale në Detashmentin e Mbështetjes Rajonale, Mengel, janë angazhuar në mbështetje të emergjencave civile në bashkinë Elbasan. Situata e krijuar si rezultat i temperaturave të larta ka kërkuar ndërhyrjen e specializuar të strukturave të Komandës Mbështetëse, të cilat i janë përgjigjur menjëherë thirrjes së autoriteteve lokale për normalizimin e situatës në vendin e quajtur “Mali i Krastës”. Të kompletuar me pajisje individuale dhe ato kolektive, efektivët u dislokuan në vendin e operacionit dhe me këmbëngulje e profesionalizëm bënë të mundur vënien në kontroll deri në shuarjen e plotë të vatrës së zjarrit në malin e Krastës. Detashmenti i Mbështetjes Rajonale, Mengel, me kapacitetet e duhura operacionale dëshmon se në çdo kohë është pranë komunitetit për të mbrojtur e jetën e banorëve dhe mjedisin përreth.



Stërvitja fushore/ujore e Batalionit të Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale, e koduar “Mburoja Ilire 50-25”, u zhvillua në rajonin stërvitor të Distriktit Detar Jugor, në Pashaliman, me synim zhvillimin e kapaciteteve për operacione speciale ujore dhe nënujore, nëpërmjet ndërthurjes së veprimeve tokësore, detare dhe ajrore.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Të kërkosh falje kur je gabim,
një dritare drejt ndjenjave njerëzore

Në një kohë kur komunikimi është bërë më i shpejtë por më i cekët, kur ndjeshmëria zëvendësohet shpesh nga krenaria dhe kur njerëzit më shumë dëgjojnë për t’u përgjigjur sesa për të kuptuar, të kërkosh falje kur je gabim mbetet një akt i rrallë por thellësisht njerëzor. Kjo sjellje, e cila në dukje është e thjeshtë, mbart në vetvete një mori ndjenjash, bindjesh dhe përplasje vlerash që e bëjnë të rëndësishme për analizë, jo vetëm në aspektin moral, por edhe në atë shoqëror, psikologjik dhe kulturor.

Pranimi i gabimit, reflektim i vetëdijes personale

Të kërkosh falje nënkupton, para së gjithash, njohjen e një gabimi. Por për ta bërë këtë, nevojitet diçka më shumë se njohuri, nevojitet vetëdije. Vetëdija për veten, për ndikimin që kemi te të tjerët, për ndjenjat që i kemi lënduar, dhe për rëndësinë që ka drejtësia në marrëdhëniet njerëzore. Pranimi i fajit është një akt i thellë reflektimi dhe ndershmërie, sepse njeriu, në thelb, është krijesë me mangësi dhe ajo që e dallon nuk është mungesa e gabimeve, por përballja me to.

Në shoqërinë tonë, që shpesh inkurajon “të jesh i fortë”, kjo përballje shihet si dobësi. Por në fakt, vetëm njeriu me karakter të ndërtuar mbi ndershmëri e vetëvlerësim të shëndoshë mund të pranojë hapur se ka gabuar. Kjo nuk është thjesht ndjenjë faji, është rritje.

Ndikimi i kërkimit të faljes në marrëdhëniet ndërnjerëzore

Asnjë marrëdhënie, qofshin miqësi, dashuri, familje apo bashkëpunim profesional, nuk është e imunizuar nga konfliktet.

Gabimet ndodhin, por ajo që vendos fatin e këtyre marrëdhënieve është mënyra si përballohen ato. Një kërkim faljeje i sinqertë ka fuqinë të shërojë plagë emocionale, të rindërtojë besimin dhe të afrojë njerëzit. Përkundrazi, refuzimi për të kërkuar falje, në shumë raste, sjell largësi emocionale, ftohtësi dhe ndarje.

Kur dikush thotë “më fal”, ai/ajo nuk po heq dorë nga dinjiteti, por po e forcon atë. Sepse kjo tregon gatishmëri për të vënë interesin e marrëdhënies mbi egon personale, një gjest i rrallë dhe thellësisht i çmuar në një botë gjithnjë e më individualiste.

Kultura e krenarisë dhe mungesa e ndjeshmërisë

Në shumë kultura, përfshirë edhe atë shqiptare, është rrënjësuar ideja se “të pranosh fajin është dobësi”. Sidomos për burrat, një kërkim faljeje shihet shpesh si një cenim i autoritetit apo i imazhit publik. Nga ana tjetër, gratë shpesh detyrohen të kërkojnë falje për paqen, edhe kur nuk janë fajtores, çka e tregon qartë se kërkimi i faljes është bërë jo një akt ndjeshmërie, por një manovër e sjelljes së diktuar nga rolet gjinore dhe presioni shoqëror.

Kjo tregon se nevojitet një riformatim i mendësisë kolektive, ku të kërkosh falje të mos shihet si cenim, por si shenjë pjekurie, si manifestim i ndjeshmërisë dhe si një nga mënyrat më të larta të shprehjes së dashurisë, respektit dhe përgjegjësisë.

Të kërkosh falje çliron një barrë emocionale. Njeriu nuk është robot, ai e ndien peshën e një gabimi, edhe kur nuk e pranon me fjalë. Kërkimi i faljes është një mënyrë për të balancuar



brendinë e vetes, për të jetuar në paqe me ndërgjegjen. Po ashtu, kur një njeri kërkon falje, ai tregon se e kupton dhimbjen që i ka shkaktuar dikujt tjetër, një shprehje e drejtpërdrejtë e ndjeshmërisë.

Nga ana tjetër, refuzimi i kërkimit të faljes shpesh buron nga frika, frika nga refuzimi, nga humbja e kontrollit, nga ballafaqimi me vetveten. Dhe ky është një sinjal i fortë se mungesa e kërkimit të faljes është, në thelb, mungesë fuqie shpirtërore.

Rëndësia e edukimit dhe shembullit personal

Nëse duam një shoqëri më të drejtë, më të ndjeshme dhe më të bashkuar, duhet të nisim nga shembulli personal. Prindërit duhet t’u kërkojnë falje fëmijëve kur gabojnë, mësuesit nxënësve, drejtuesit punonjësve, sepse në këtë mënyrë ndërtohet një kulturë ku ndershmëria ka më shumë vlerë sesa autoriteti i verbër.

Media, edukimi, madje edhe teknologjia, duhet të promovojnë

modelin e njeriut të ndërgjegjshëm, jo vetëm të suksesit të jashtëm. Sepse suksesi më i madh nuk është fitorja ndaj të tjerëve, por fitorja ndaj vetes kur ajo të nxit të heshtësh, por ti zgjedh të thuash: “Kam gabuar. Më fal!” Ajo që na bën njerëz nuk është pamja, pozita apo pasuria, janë ndjenjat, reflektimet dhe veprimet që i pasqyrojnë ato.

Ka diçka fisnike në pranimin e fajit. Është një akt që pastron zemrën, lehtëson mendjen dhe forcon lidhjet ndërnjerëzore. Në një shoqëri ku shprehjet e ndjeshmërisë shpesh keqinterpretohen si dobësi, të kërkosh falje bëhet një formë rezistence një mënyrë për të thënë: “Unë zgjedh të jem më i mirë, jo më i fortë me çdo kusht”.

Vetëm një shoqëri që di të kërkojë falje mund të ndërtojë marrëdhënie të qëndrueshme, institucione të ndershme dhe një botë më të drejtë.

TË KËRKOSH FALJE
NËNKUPTON, PARA SË
GJITHASH, NJOHJEN E NJË
GABIMI. POR PËR TA BËRË
KËTË, NEVOJITET DIÇKA
MË SHUMË SE NJOHURI,
NEVOJITET VETËDIJE.
VETËDIJA PËR VETEN, PËR
NDIKIMIN QË KEMI TE TË
TJERËT, PËR NDJENJAT
QË I KEMI LËNDUAR,
DHE PËR RËNDËSINË
QË KA DREJTËSIA NË
MARRËDHËNIET NJERËZORE.

NË SHUMË KULTURA, PËRFSHIRË
EDHE ATË SHQIPTARE, ËSHTË
RRËNJËSUR IDEJA SE “TË
PRANOSH FAJIN ËSHTË DOBËSI”.
SIDOMOS PËR BURRAT, NJË
KËRKIM FALJEJE SHIHET SHPESH
SI NJË CENIM I AUTORITETIT
APO I IMAZHIT PUBLIK. NGA
ANA TJETËR, GRATË SHPESH
DETYROHEN TË KËRKOJNË FALJE
PËR PAQEN, EDHE KUR NUK JANË
FAJTORE, ÇKA E TREGON QARTË
SE KËRKIMI I FALJES ËSHTË BËRË
JO NJË AKT NDJESHMËRIE, POR
NJË MANOVËR E SJELLJES SË
DIKTUAR NGA ROLET GJINORE
DHE PRESIONI SHOQËROR.

Teknologjia si Armatim: Lufta e Re e Shekullit XXI në Arenën Ushtarake

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

*“Lufta e së ardhmes do të fitohet nga ata që
zotërojnë informacionin, jo vetëm armët”*

Në një epokë ku çdo klikim, postim dhe bashkëbisedim virtual mund të shndërrohet në armë, forcat tona ushtarake përballen me sfida që shtrihen përtej frontit të armatosur. Nuk është më e mjaftueshme të zotërosh armë të sofistikuara; përparësi strategjike ka ai që kontrollon informacionin, ai që kupton rrjetet dhe ai që përdor inteligjencën artificiale.

Nga zhvillimet në Ukrainë deri te marrja e kërcënimeve hibride në Ballkan, tregojnë se luftërat e reja nuk shpallen lirisht, ato gjarpërojnë nëpër valët e internetit dhe algoritmet e rrjeteve sociale.

Një sulm kibernetik mund të ngadalësojë shërbimet kritike, ndërsa një fushatë dezinformimi mund të shkatërrojë besimin gjithëpërfshirës të shoqërisë.

Kriza e Informacionit: Arma e Heshtur dhe e Ndikimit Global

Kjo fushë përfshin ndërhyrje në rrjete elektrike, banka, sistemet e ujësjellësit dhe strukturat infrastrukturore, si edhe spiunazh kibernetik ndaj institucioneve shtetërore.

Një dëmtim në mënyrë të dhunshme, pa shkaktuar viktima, mund të paralizojë qeverisjen dhe besueshmërinë ndaj shtetit.

Dezinformimi strategjik

Nëpërmjet profileve false dhe mesazheve të orkestruara, informacioni i rremë përhapet si epidemi. Në situata të tensionuara politike ose emergjencash kombëtare, një postim i manipulueshëm mund të nxisë panik, zemërim dhe destabilizim. Ushtria duhet të jetë në gjendje të zbulojë dhe kundërshtojë menjëherë këto fushata.

Inteligjenca artificiale si mjet strategjik

AI-ja përdoret për analizimin e volumit të madh të të dhënave, për përlllogaritje parashikimi të vizatimit të skenarëve armik dhe për identifikim të anomalive strategjike në komunikime dhe lëvizje.

Operacionet psikologjike online

Një pjesë e rëndësishme e luftës informative. Duke përdorur video, meme, storytelling digjital apo filmime të manipuluara, krijohet ndjesi frike ose pasigurie në popullatë.

Ushtria e shekullit XXI duhet të ketë njësinë e vet të komunikimit digjital, që të reagojë dhe të rishfaqë narrativat strategjike për të mos lejuar mos njohjen digjitale.

Sfida dhe Përgjigje në Shqipëri dhe NATO

Përfiton nga akseset në inteligjencë strategjike dhe trajnime të rregullta në fushën e mbrojtjes. Nuk përjashtohet edhe përvoja e drejtpërdrejtë në ushtritë anëtare, si SHBA, Kanada, Britani. Partneriteti ofron mundësi investimi të huaj për ndërtimin e qendrave të përbashkëta të mbrojtjes.

Nisma kombëtare për forcimin e mbrojtjes

Krijimi i Njësisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike brenda Ministrisë së Mbrojtjes; Investim në laboratorë simulative për sulmet kibernetike dhe testime të rezistencës; Politika të qarta ndaj sektorit privat për bashkëpunim në fushat me interes strategjik (telekomunikime, energji, IT).

Edukimi dhe trajnimi i personelit ushtarak

Ushtria duhet të inkurajojë oficerët dhe specialistët të ndjekin kurse mbi AI, kriptografi, analizë të të dhënave, sjellje elektronike. Mishërimi i logjikës digjitale në kurrikulën akademike është vendimtar për ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Ndërprerja e marrëveshjeve të fushatave të përbashkëta, shkëmbimi i informacionit për kërcënimet hibride dhe cyber-entuziaste.



AI-JA PËRDORET PËR ANALIZIMIN E VOLUMIT
TË MADH TË TË DHËNAVE, PËR PËRLLOGARITJE
PARASHIKIMI TË VIZATIMIT TË SKENARËVE
ARMIK DHE PËR IDENTIFIKIM TË ANOMALIVE
STRATEGJIKE NË KOMUNIKIME DHE LËVIZJE.

Projekte si NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence dhe Iniciativa Europiane për Mbrojtjen Kibernetike janë projekte që ofrojnë asistencë për vendet si Shqipëria.

Kultura Digjitale Ushtarake & Pritshmëri Strategjike

Ndryshimi i kulturës organizative: Ushtria duhet të kultivojë vetë-mbrojtje dinamike, ku edhe oficerët e zakonit kanë vetëdijen për rrezikun e informacionit të falsifikuar, phishing, dhe sulmeve në distancë.

Protokolle komunikimi të sigurt: Adoptimi i sistemeve të enkriptimit për mesazhe, llojeve të reja të rrjeteve ushtarake që janë rezistente ndaj ndërhyrjeve elektronike, ku përditësimet bëhen me frekuenca të rastësishme dhe mesazhet burojnë vetëm për palë si “zero-trust”.

Inovacioni në drejtim të autonomisë teknologjike

Shqipëria mund të fillojë zhvillimin e zgjidhjeve softuerike

kombëtare për analizën kibernetike, duke përdorur inteligjencën artificiale të trajnuar mbi të dhëna lokale, dhe duke krijuar prototipe sensorësh dometikë për mbrojtjen fizike dhe kibernetike.

Transparenca dhe reputacioni ndërkombëtar

Duke demonstruar publikisht investime në cyber mbrojtje dhe luftën informative, ne forcojmë kredibilitetin e Shqipërisë si kontribuuese serioze në sigurinë e rajonit dhe si partner i besueshëm i NATO-s dhe BE-së.

Në këtë betejë të re, informacioni është forca, teknologjia është armatimi, dhe kultura e sigurisë digjitale është mburoja.

Shqipëria nuk ka luksin për të mbetur pas. Transformimi nuk është vetëm një zgjedhje por është një detyrim kombëtar dhe një hap në drejtim të besueshmërisë dhe autoritetit ndërkombëtar. Ushtria jonë duhet të jetë jo më pak se një lider në këtë epokë të re, që ka të ardhmen e betejave në valët digjitale.



Me Uniformë për Kombin:

Disiplina dhe Dinjiteti në Shërbim

Uniforma ushtarake e Forcave të Armatosura të Shqipërisë ka një rol dhe rëndësi të shumëfishtë në funksionimin, identitetin dhe disiplinën e ushtrisë.

Identiteti dhe përfaqësimi

Uniforma është simbol i përkatësisë ndaj ushtrisë shqiptare dhe përfaqëson shtetin shqiptar brenda dhe jashtë vendit. Ajo tregon se personi që e mban është pjesë e një strukture zyrtare të mbrojtjes së vendit.

Disiplina dhe organizimi

Përdorimi i uniformës nxit disiplinën dhe përforcon ndjenjën e barazisë dhe përkushtimit në radhët e ushtarakëve. Të gjithë pjesëtarët e Forcave të Armatosura, pavarësisht gradës, ndajnë një kod të përbashkët përmes uniformës.

Dallimi i gradave dhe funksioneve

Uniforma përmban elementë që ndihmojnë në identifikimin e gradës, repartit, dhe specialitetit të çdo ushtari. Kjo është e rëndësishme për funksionimin efektiv të komandimit dhe zinxhirit hierarkik.

Mbrojtja dhe përshtatja me mjedisin

Uniformat moderne ushtarake janë të dizajnuara për të ofruar mbrojtje fizike, komoditet dhe kamuflim në terrene të ndryshme, sipas nevojave të misionit (fusha, mal, qytet, etj.). Ato përfshijnë materiale rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe faktorëve të tjerë të jashtëm.

Moral dhe krenari

Për shumë ushtarakë, uniforma është burim krenarie dhe simbol i nderit për shërbimin ndaj atdheut. Ajo luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e moralit dhe motivimit të trupave.

Funksionet ceremoniale dhe zyrtare

Përveç uniformës së përditshme, Forcat e Armatosura përdorin uniforma ceremoniale në raste shtetërore,

Më Shumë se Veshje: Uniforma Ushtarake, Nderi i Shërbimit Shqiptar



UNIFORMA ËSHTË SIMBOL I PÛRKATËSISË NDAJ USHTRISË SHQIPTARE DHE PÛRFAQËSON SHTETIN SHQIPTAR BRENDË DHE JASHTË VENDIT. AJO TREGON SE PERSONI QË E MBAN ËSHTË PJESË E NJË STRUKTURE ZYRTARE TË MBROJTJES SË VENDIT.

përvjetorë ushtarake, ose ngjarje ndërkombëtare ku përfaqësohet ushtria shqiptare.

Këto uniforma ruajnë elemente tradicionale dhe historike. Uniforma ushtarake është më shumë sesa një veshje, ajo

është një përfaqësim i vlerave të shërbimit ushtarak, një mjet funksional për misionet në terren, dhe një simbol kombëtar që mbart mbi vete historinë, përkushtimin dhe dinjitetin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Rregullat për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e uniformës

Ushtarakë janë përgjegjës për mbajtjen e uniformës në gjendje të pastër dhe të mirëmbajtur. Rregullorja e AFA-së specifikon se kontrata e shërbimit përfshin edhe detyrën për ruajtjen e uniformës.

Shtrirja e uniformës në detyrë

Uniforma është veshje zyrtare në të gjitha aktivitetet si trajnime, angazhime zyrtare dhe operacione ndërkombëtare. Duke respektuar rregullat nuk lejohet shkelje si të paraqitjes pa uniformë në shërbim.

Përforcimi i përshtatjes me formatin e NATO-s pas 1991, me përdorim të gradave, simboleve të njësive dhe flamurit në uniformë.

Kontrata e shërbimit

Në Udhëzimin nr. A S, data 08/10/2014, përcaktohet kontrata ndërmjet ushtarakut dhe forcës me detyrimet e ruajtjes së uniformës, përkujdesit ndaj saj dhe shërbimeve të tjera të lidhura.

Uniformat shqiptare ushtarake kanë reflektuar transformime të thella historike nga ndikimet italiane dhe sovjetike te ato perëndimore dhe NATO-s.

Sot, ato janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rregullat e kontratës së shërbimit i imponojnë ushtarakëve përgjegjësinë për mbajtjen, pastrimin dhe përdorimin korrekt të uniformës në çdo aktivitet zyrtar.

Normat ligjore dhe vendimet për uniformën

VKM 150/13.3.2023 vendos kriteret dhe normat e trajtimit me uniformë për ushtarakët aktivë dhe studentët ushtarakë, brenda dhe jashtë vendit.

Ushtarakëve që dërgohen në misione jashtë vendit u sigurohen uniforma stërvitjeje të përshtatura për kushtet e misionit.

Uniformat, gradat dhe simbolet jepen falas, dhe në rast lirie, rezervë apo tragjedi, ushtarakët përfitojnë uniformë ceremoniale.

Sjellja në publik me uniformë (jashtë detyrës)

Lejohet vetëm në aktivitet të lidhur me detyrën ushtarake. Nuk përdoret në ambiente si bare, tregje, plazhe, ose për përfitime personale jashtë shërbimit.

Nuk duhen ekspozuar pajisje apo simbolika ushtarake në kontekste jozyrtare, për të ruajtur imazhin institucional.

Sjellja gjatë detyrës apo misionit

Gjatë shërbimit, ushtarakët duhet të respektojnë kodin e sjelljes: respekt ndaj kolegëve, hierarkisë, shmangie diskriminimi, dhe sjellje profesionale.

Gjatë kohës me uniformë, ndalohet përdorimi i alkoolit apo substancave të ndaluara.

Konfidencialiteti i informacionit gjatë shërbimit është i pazëvendësueshëm.

Përdorimi dhe ruajtja e pajisjeve, armëve dhe uniformës duhet të jetë sipas standardeve dhe vetëm për qëllime shërbimi.

Uniforma duhet të jetë e përshtatshme, e pastruar, e palosur mirë, duhet të përmbushë standardet e duhura për

pamjen fizike.

Flokët, mjekra (gjinia mashkullore) dhe kozmetika (gjinia femërore) duhet të përmbushin standardet ushtarake, si p.sh. flokët e shkurtër për meshkujt dhe kozmetika diskrete për femrat.

Thonj të pastër dhe të shkurtër, pa bizhuteri të ekzagjeruara dhe syze të përshtatshme me rregullat.

Sjellja gjatë misioneve jashtë vendit

Uniforma dhe pajisjet bëhen sipas kërkesave specifike të misionit (kamufllazh të përshtatshëm për terrenet dhe klimën e atij vendi).

Gjatë aktiviteteve ceremoniale apo zyrtare jashtë vendit, duhet respekt i rreptë i etikës ushtarake dhe formacione të paracaktuara.

Mbrojtja e imazhit institucional dhe evitimi i përfshirjeve në ngjarje politike janë thelbësore.

Disiplinat dhe shkeljet e rënda

Shkeljet e rënda përfshijnë: publikime të paautorizuara, kritika publike, shkelje të politikave me uniformë (p.sh. alkooli, bixhozi, falja fetare me uniformë). Mbajtja e uniformës ushtarake kërkon disiplinë të lartë, nga pamja personale, mënyra se si vishet, deri te sjellja profesionale në publik dhe në misione.

Sjellje dinjitoze, respekt për strukturat, kujdes për simbolet dhe shmangia e aktivitetit jozyrtar janë thelbësore për ruajtjen e autoritetit dhe imazhit të FA-së.





Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Gora e lavdisë partizane

Duke studiuar për historinë e dëshmorëve të bashkisë Pogradec u gjenda përpara një historie të ngjashme me historitë dhe trimëritë e gruas shqiptare në shekuj. Merko e Shqipërie Selmanllari, nënë e bijë u vranë në prapun e shtëpisë nga pushtuesit gjermanë për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e familjes dhe vendit të tyre.

Ngjarja ka ndodhur në fshatin Dolanec në krahinën e Gorës, një krahinë me histori të lashtë, histori që fillon në Maliqin e lashtësisë, e që vijnë më pas me fiset ilirë të shquar të Taulantias. Historia e Gorës është luftarake dhe e lavdishme. Burra dhe gra nga Gora i bëjnë nder historisë kombëtare, me çetat atdhetare në ndihmë të Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë së Shqipërisë. Bij të trevës, kapedanë të shquar si Kajo Babieni, Shahin Matraku, Malkë Zvarishti, Ismail Dërdusha etj., i kanë dhënë nder dhe lavdi krahinës. Historitë dhe bëmat e tyre frymëzuan burrat dhe gratë e krahinës në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gorarët mbushën rreshtat e çetave, batalioneve e brigadave partizane të komanduara nga Heroi i Popullit Teki Kolaneci e komandantë e komisarë, bij e bija të krahinës legjendare.

Në këtë histori të lavdishme të Gorës, në të gjithë kohët, ka ngelur i vetmi dëshnimtar që është Guri i Kamjes, monument i lavdishëm shekullor dhe i përjetshëm i natyrës. Ky gur ka ngelur në shekuj një pikë referuese për shumë ngjarje historike e ndodhi të mëdha. Aty janë mbledhur gorarët dhe kanë marrë vendime historike, janë bërë organizime të mëdha, kanë lidhur besën gorare për t'i bërë ballë të keqes e pushtuesve të huaj, që kanë qenë të shumtë për të pushtuar krahinën me histori të madhe dhe të lavdishme.

Kapedanët që frymëzuan breza

Ismail Dërdusha ishte kapedan çete patriotike në Dërdushë të Gorës. Jeta e tij ka kaluar në punë dhe në luftë për të mbajtur ndezur idetë patriotike e liridashëse. Ai kishte bërë emër në Gorë, Opar e Mokër. Ismaili ishte nipi i Kajo Babjenit, një kapedani tjetër i zonës legjendare. Në vitin 1885, në moshën 17 vjeçare, ishte bashkuar me çetat e Kajo Babjenit e Shahin Matrakut. Ishte Ismaili me çetën e tij, që nuk i lejoi xhandarët e administratës osmane të vilnin tatimet në Gorë. Aktin e tij e vlerësoi populli, ndaj e donte dhe e mbronte kapedantin që ishte roje i tij, për të mos i zhvatur si pushtuesi, ashtu dhe bejlerët e agallarët e vendit. Me krijimin e Komitetit të Fshehtë të Manastirit që kërkonte lirinë e Shqipërisë dhe takimi me kapedanët gorarë, Ismaili u vu në krye të lëvizjes, duke luftuar për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Zona e veprimtarisë së luftimeve shtrihej nga Lenia deri në Malin e Thatë. Ai e kishte njoftuar Kajmekamin e Pogradecit, që të mos dërgonte taksambledhësit në fshatrat e Gorës, sepse fshatarët ishin shumë të varfër e s'kishin çfarë të jepnin. Ndaj çdo forcë që do të përdorej, do goditej nga çetat e Gorës.

Në vitin 1911 në Gurin e Kamjes Ismail Dërdusha u ndesh me taksambledhësit e qeverisë, të cilët u detyruan të ktheheshin mbrapsht në Pogradec. Por, po në vitin 1911 në fshatin Pretushë, forcat qeveritare i zunë pritë me xhandarë të shumtë dhe e vranë kapedantin Ismail Dërdushën së bashku me kapedantin tjetër të zonës, Seit Zakoçanin.


Luftëtari Tosun Dërdusha ishte një patriot tjetër nga fisi luftarak Dërdusha. Shtëpia e tij ishte një bazë patriotike. Kështu, në shtëpinë e Tosunit në Dërdushë, në vitin 1907, u mbledhën krerët e Gorës dhe mbajtën një kuvend të kapedanëve të zonës. Fisi Dërdushë historikisht ka mbajtur qëndrim patriotik, në kohën e Rilindjes, të Pavarësisë, të LANÇ-it dhe pas çlirimit. Në këtë fis lindi, u rrit, u edukua dhe aktivistja Meriko Halit Dërdusha, e cila shkoi nuse në fisin Selmanllari në fshatin Dolanec të Gorës.

Aktivistja e gruas në krahinë

Meriko Selmanllari e lindur në vitin 1902, në Dërdushë, ishte mbesa e kapedan Ismail Dërdushës. Në familjen e burrit, ajo gërshetoi traditat dhe zakonet e famljes Dërdusha me ato të familjes Selmanllari. Meriko u bë një veprimtare e shquar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e ktheu shtëpinë e saj në bazë të luftëtarëve të lirisë.

Ndër gratë aktiviste në Gorë, në periudhën e lëvizjes u shquan Medije Braçe, e cila ishte dhe delegate në Kongresin e Gruas Antifashiste në Berat në nëntor 1944, Fiqirie Kolaneci, aktiviste e shquar e gruas në krahinë, Nënë Pashako, trimëreshë dhe legjendë

NËNË E BIJË PËR ATDHE, HISTORIA E LAVDISHME E MERIKO DHE SHQIPËRIE SELMANLLARIT



Merko Selmanllari

e gruas gjatë LANÇ-it, Fike Grybeci, anëtare e Organizatës së Gruas Antifashiste në Gorë, si dhe Meriko Selmanllari, aktiviste e gruas në krahinë.

Shqipërie B. Selmanllari ishte e bija e Merikos e lindur në vitin 1926 në fshatin Dolanec. Edhe Shqipëria u aktivizua me lëvizjen, me organizatën e rinisë dhe ka ndihmuar dhe njësitin partizan të fshatit Dolanec.

Historia e tyre është një histori trimërore që është në vazhden e trimëreshave të kohëve, të Shqipëries si të Shote Galicës, të Tringës së Grudës e Tringës së Hotit, të Maro Kondës dhe të Liri Geros, të Sartë Gabaj dhe të Qybra Sokolit etj.


Trimëria e Merikos dhe Shqipëries ka një dukuri të re, të veçantë dhe të traditës. Meriko ishte edukuar me trimërinë, ishte mbesë e një kapedani të njohur të Gorës, të Ismail Dërdushës, ishte mbesë e gjyshes së saj, Fatime Dërdushës.

Historia e Fatimes tregohej si një legjendë. Nëna, si një lajmëtare për bijtë e saj, vërejti se shtëpia e saj po rrethohej nga turqit. I biri Ismaili me luftëtarët e çetës gjendej në shtëpi. Nëna, doli nga tuneli i nëndheshëm, zbuloi pozicionet që kishin zënë turqit, dhe ia tregoi të birit. Kapedani doli nga shtëpia me luftëtarët dhe i shpartalloi turqit.

Historia që ripërtërihet...

